

**A K T            T H E M E L I M I**

**I**

**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"SH.A.G.A" SH.P.K.**



Me ane te ketij Akti Themelimi, ORTAKU I VETEM, z. Artan Zemani, i biri i Bilalit dhe Bilbiles, i datelindjes 1970, lindur ne Vlore, banues ne Vlore lagja "29 Nentori"

**V E N D O S I**

Te themeloje Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar, emertimi i pote i se ciles eshte : **"SH.A.G.A SH.P.K"**.

**NENI 1**

**SELIA E SHOQERISE**

Selia e Shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranes, me adresë Rruga e Durresit ish Pularia.

**NENI 2**

**OBJEKTI I SHOQERISE**

Objekti i veprimitarise se SHOQERISE eshte:

**SHOQUERIA** ushtron cdo lloj operacioni dhe transaksiuni ne lidhje me importimin, eksportimin, prodhimin, shperndarjen dhe tregetimin e mallrave te ndryshme ushqimor, industrial, konfeksione, hidrosanitare, pajisjeve mobilerie e shtepiake ne pergjithesi, elektro-shtepiake, kancelarike dhe te zyrave, si me shumice dhe pakice, ne natyren e lendet se pare, produkteve gjysem te gatshme apo te gatshme, makinerive e pajisjeve, pjeseve te ndertimit, teknologjive. Perpunimin dhe tregetimin e lendet drusore.

**SHOQUERIA** ushtron aktivitetin e prodhimit, ambalazhimit dhe tregetimit ne cdo forme te ujit mineral, lengjeve te embla, pijeve freskuese dhe alkoolikedhe



- 2 -

prodhimeve te ngjashme me to, si dhe prodhimin dhe tregetimin e shperndarjen e ambalazheve te cdo forme etj.

**SHOQERIA** ushtron veprimtarine e blerjes, shitjes apo dhenies me qera te pasurive te palujtshme, si banesa, troje, etj., nepermjet ngritjes se zyrave perkatese qe do te ushtroj kete lloj aktiviteti.

**SHOQERIA** ushtron veprimtarine per dhenien e konsulences teknike ne fushat e ndryshme, qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se shoqerise, ushtron veprimtarine e perfaqesimit te ndermjetesimit apo te lidhjes se kontratave ndermjet subjekteve te ndryshme private apo shteterore, vendase apo te huaja.

**SHOQERIA** ka te drejten qe brenda kufijve te lejuar nga Legjislacioni Shqiptar, duke perjashtuar cdo qellim spekulativ, te marre pjesa ne fitime dhe/ose ne shoqeri te tjera te se drejt shqiptare apo te shteteve te tjera.

### NENI 3

#### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e **SHOQERISE** eshte caktuar 10 vjet deri ne daten 31.12.2009. Me vendim te ORTAKUT TE VETEM, kohezgjatja e SHOQERISE mund te caktohet pertej asfatit te percaktuar ne paragrafin e mesiperme.

### NENI 4

#### PERSONALITETI JURIDIK

**SHOQERIA** fiton persoalitet juridik ne diten e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane, ndersa veprimtaria tregetare e saj fillon me regjistrimin ne organet tatumore.

### NENI 5

#### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i **SHOQERISE** eshte 100 000 (njeqind mijë) leke.

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar behet me vendim te ORTAKUT TE VETEM.

Fondi ne te holla qe vjen nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar depozitohet per llogari te **SHOQERISE** ne Banken Kombetare Tregtare, dega Tirane.



Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar behet nga ORTAKU I VETEM me akt noterial.

### **NENI 6**

**SHOQERIA** e ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me kete AKT THEMELIMI,STATUTIN e saj si dhe me dispozitat e Legjislacionit Tregtar Shqiptar.

### **NENI 7**

### **ADMINISTRIMI**

**SHOQERIA** administrohet nga Administratori i saj,emeruar nga ORTAKU I VETEM, qe do te jete zj. Rezarta Denaj,e cila perfaqeson SHOQERINE ne maredhenie me te tretet.

ORTAKU I VETEM ose ADMINISTRATORI mbajne pergjegjesi per te gjithe veprimtarine e SHOQERISE qe nga themelimi i saj.

Vendimet e ORTAKUT TE VETEM evidentohen ne nje regjister te vecante.

### **NENI 8**

### **SHNDERIMI I SHOQERISE**

**SHOQERIA** mund te shnderrohet ne nje shoqeri kolektive,komandite,anonime me vendim te ORTAKUT TE VETEM dhe ne perputhje me Legjislacionin Tregtar Shqiptar.

### **NENI 9**

### **PRISHJA E SHOQERISE**

**SHOQERIA** prishet ne rastet kur:

- a- mbaron afati i percaktuar ne kete Akt Themelimi;

b- nuk mund te realizohet objekti i SHOQERISE sipas Aktit te Themelimit  
dhe Statutit;

c- nje vendim te tille e merr ORTAKU I VETEM.

### NENI 10

### HYRJA NE FUQI

Ky Akt Themelimi hyn ne fuqi diten e nenshkrimit te tij perpara Noterit.

### ORTAKU I VETEM


*(Artan Zemani)*  
*Armen*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA TIRANE  
NR.....<sup>50</sup>....REP.  
NR.....<sup>20</sup>....KOL.

Tirane, me 14/01/1999

### VERTETIM

Sot me daten 14/01/1999 (nentedhjete e nente), para meje  
Noteres Raymond Dyrmishi, u paraqit z. Artan Zemani, i biri i  
Bilalit, d.tl. 1970, lindur ne Vlore, banues ne Vlore, identitetin e te cilit e sigurova  
nepermjet passaportes se tij personale me nr. 0485603, madhore dhe me zotesi te  
plete per te vepruar, i cili deklaroj se sa me siper eshte nje **AKT THEMELIMI** i  
Shoqerise Tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "SH.A.G.A  
sh.p.k" i perpiluar jashtë kesaj zyre dhe, pasi e lexoi, e kuptoi, e pranoi dhe e  
nenshkroi rregullisht sipas ligjit, Une Noterja e vertetoj dhe e nenshruaj sipas  
ligjit.



NOTE

Raymond Dyrmishi

# STATUT

## I



## SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## "SH.A.G.A" SH.P.K.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "SH.A.G.A" "SH.P.K." (e cila ketu me poshte quhet "Shoqeria") eshte themeluar ne baze te Aktit te Themelimit me dt. 08.01.1999 nga zoti Artan Zemani, i biri i Bilalit dhe Bilbiles, d.t. 1970, lindur ne Vlore banues ne Vlore, lagja 29 Nentori, (i cili me poshte do te quhet **ORTAKU I VETEM**).

Kjo SHOQERI ne perputhje me legjislacionin shqiptar e vecanerisht me Ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", krijohet nga ORTAKU I VETEM per te ushtruar veprintari te ndryshme sipas parashikimeve te bera ne Aktin e Themelimit apo nga ky STATUT.

### NENI 1

#### EMERTIMI

**SHOQUERIA** emertohet "SH.A.G.A sh.p.k".

**SHOQUERIA** eshte person juridik i se drejtes shaiptare dhe zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar si dhe dispozitat e Aktit te Themelimit dhe te ketij STATUTI.

**SHOQUERIA** do te quhet person juridik dhe do te veproje si e tille duke filluar nga dita e regjistrimit te saj ne gjykate, ndersa veprimtaria ekonomike fillon me regjistrimin e saj ne organet tatimore.

### NENI 2

#### OBJEKTI I SHOQUERISE

Objekti i veprimtarise se SHOQUERISE eshte :

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Artan Zemani".



- 2 -

**SHOQERIA** ushtron cdo lloj operacioni dhe transaksiioni ne lidhje me importimin, eksportimin, prodhimin, shperndarjen dhe tregetimin e mallrave te ndryshme ushqimore, industriale, konfeksione, hidrosanitare, pajisje mobilerie e shtepiake ne per gjithesi, elektro-shtepiake, kancelarike dhe te zyrave, si me shumice dhe pakice, ne natyren e lendet se pare, produkteve gjysem te gatshme apo te gatshme, makinerive, pajisjeve, pjeseve te ndertimit, teknologjive, perpunim dhe tregetim te lendet drusore.

**SHOQERIA** ushtron aktivitetin ne prodhimin, ambalazhimin dhe tregetimin ne cdo forme te ujit mineral, lengjeve te embla, pijeve freskuese dhe alkoolike dhe prodhimeve te ngjashme me to, si dhe prodhimin, tregetimin, shperndarjen e ambalazheve te cdo forme etj.

**SHOQERIA** ushtron veprimtarine e blerjes, shitjes apo dhenies me qera te pasurive te palujtshme, si banesa, troje, etj., nepermjet ngritjes se zyrave perkatese qe do te ushtroj kete lloj aktiviteti.

**SHOQERIA** ushtron veprimtarine per dhenien e konsulences tekniqe ne fushat e ndryshme qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se shoqerise, ushtron veprimtarine e perfaqsimit te ndermjetesimit apo te lidhjes se kontratave ndermjet subjekteve te ndryshme private apo shteterore, vendase apo te huaja.

**SHOQERIA** ka te drejten qe, brenda kufijve te parashikuara ne legjislacionin shqiptar, duke perjashtuar cdo qellim spekulativ, te marre pjesa ne fitime dhe/ose ne shoqeri te tjera te se drejtes shqiptare apo te shteteve te tjera si dhe te krijoje shoqeri te tjera tregtare me persona e subjekte publike apo private, vendase ose te huaja.

### NENI 3

#### QENDRA E SHOQUERISE

Qendra e **SHOQUERISE** ndodhet ne qytetin e Tiranes ne adresen : rruga e Durresit, ish Pularia.

**SHOQUERIA**, me vendim te organeve te saj kompetente, rast pas rasti, do te krijoj, transferoj dhe /ose anulloj seli dytesore, seli administrative, drejtori, filiale, dege, agjensi dhe zyra si ne territorin shqiptar ashtu edhe jashte vendit.

#### NENI 4

### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e **SHOQERISE** eshte caktuar 10 vjet deri me 31.12.2009.

Me vendim te **ORTAKUT TE VETEM**,kohezgjatja e **SHOQERISE** mund te caktohet tej afatit te percaktuar ne paragrafin e mesiperme.

#### NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i **SHOQERISE** eshte 100 000 (njeqind mijë) leke.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet edhe me kontribute ne natyre.

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar te **SHOQERISE** behet me vendim te **ORTAKUT TE VETEM**.

Fondi ne te holla qe vjen nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar depozitohet per llogari te **SHOQERISE** ne Banken Kombetare Tregtare,Dega Tirane.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar behet me akt notarial.

#### NENI 6


### VEPRIMET FINANCIARE

Veprimet financiare te **SHOQERISE** pasqyrohen ne llogarite (kontabilitetin)e saj, duke aplikuar kriteret e dispozitat mbi kontabilitetin e shoqerive tregtare te parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

#### NENI 7

### BLERJET E SHOQERISE

**SHOQUERIA** disponon dhe gezon pasurite e saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e themelimit te saj.



**SHOQERIA** ka te drejten e blerjes dhe administrimit te pasurive te cdo lloji e natyre si dhe te jape garanci si mjet sigurimi mbi pasurite e saj per permbushjen e detyrimeve qe merr persiper kundrejt te treteve.

### NENI 8

#### BILANCI DHE FONDET E SHOQERISE

**SHOQERIA** per ushtrimin e aktivitetit te saj krijon fondet e saj. Perberja, madhesia e tyre, burimet e krijimit, perdorimi e rregullimi i cdo fondi te vecante vendosen nga ORTAKU I VETEM duke respektuar dispozitat perkatese ne fuqi.

**SHOQERIA** disponon mjetet e saj financiare. Te gjitha detyrimet e mundshme gjate veprimtarise se SHOQERISE do te mbulohen nga fondet perkatese apo fondet rezevere, ose edhe me zmadhimin e kapitalit themeltar. Te gjitha pasurite e SHOQERISE pasqyrohen ne bilancin e saj me vlefte te shprehur ne monedhe shqiptare.

Bilanci dhe llogarite e **SHOQERISE** perpilohen e mbahen nga Administratori.

Viti finanziar (ushtrimori) fillon me daten 1 Janar dhe mbaron me daten 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik.


### NENI 9

#### ADMINISTRIMI I SHOQERISE

**SHOQERIA** administrohet nga ADMINISTRATORI, i cili eshte emeruar me vendim nga ORTAKU I VETEM, qe eshte zj. Rezarta Denaj, e cila perfaqeson SHOQERINE ne maredhenie me te tretet.

**ORTAKU I VETEM** mund ti delegoje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

Vendimet e ORTAKUT TE VETEM evidentohen ne nje rregjister te vecante.



### NENI 10

**ORTAKU I VETEM** ose administratori ushtrojne te gjitha kompetencat,te drejtat dhe detyrimet per organizimin dhe drejtimin e SHOQERISE te parashikuara nga ky STATUT,Akti i Themelimit si dhe nga legjisacioni tregtar shqiptar.  
Ata kane te drejte te kryejne te gjitha veprimet qe i konsiderojne te domosdoshme per realizimin e qellimeve te SHOQERISE,pa cenuar interesat e saj.

### NENI 11

**ORTAKU I VETEM** si dhe administratori pergjigjen per te gjithe veprimtarine e SHOQERISE qe nga momenti i themelimit te saj.

### NENI 12

### MAREDHENIET E PUNES

Maredheniet e punes ndermjet **SHOQERISE**,filialeve e agjensive te saj (nese krijohen te tilla) dhe punonjesve te saj rregullohen me kontraten e punes.Per cieshtje te paparashikuara ne kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjisacionit shqiptar.

### NENI 13

### NDRYSHIMET NE STATUT

Ndryshimet ne STATUT mund te behen me vendim te ORTAKUT TE VETEM dhe sipas dispozitave ligjore te parashikuara ne Ligjin "Per Shoqerite Tregtare".

### NENI 14

### SHNDERRIMI I SHOQERISE

**SHOQUERIA** mund te shnderohet ne nje shoqueri kolektive,komandite apo anonime me vendim te ORTAKUT TE VETEM.

Shnderrimi i **SHOQERISE** ne nje shoqueri tjeter do te konsiderohet i vlefshem vetem duke respektuar dispozitat ligjore te parashikuara nga ligji "Per Shoqerite Tregtare".

**NENI 15**

**PRISHJA E SHOQERISE**

**SHOQUERIA** prishet ne rastet kur :

- a - mbaron afati i parashikuar ne Aktin e Themelimit;
- b - nuk mund te realizohet objekti i SHOQERISE sipas Aktit te Themelimit dhe Statutit ;
- c - nje vendim te tille e merr ORTAKU I VETEM.

**NENI 16**

**LIKUIDIMI I SHOQERISE**

Likujdimi i **SHOQERISE** do te behet sipas dispozitave te legjislacionit falimentar shqiptar ne fuqi ne castin e likuidimit.

ORTAKU I VETEM vendos rregullat per proceduren e likuidimit si dhe per personat qe do ti aplikojne ato.

Ne rast prishje te SHOQERISE pasuria e mundshme qe mbetet pas shlyerjes se te gjitha detyrimeve te SHOQERISE,i mbetet ORTAKUT TE VETEM.

**NENI 17**

**DISPOZITE E FUNDIT**

Ky STATUT hyn ne fuqi diten e regjistrimit te SHOQERISE ne Gjykaten e rrethit Tirane.

Ky STATUT u njoh dhe u nenshkrua nga ORTAKU I VETEM ne Teinoce  
me 08.01.1999.

**ORTAKU I VETEM**

